



Pranimi / Dorezimi / Prilazja / Prilazje / Delivery	14.10.2022	2	viti / god / year
Organ / Shërbimi / Organizacija / Služba / Unit	Dr. Prot. / Dr. Prot. / Prof. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKOPS/SHUK	6235/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.760/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi -Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.760/2022 të datës 02.09.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë Rr.

në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.760/2022 e datës 02.09.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër të referencës 07/1-OISAP-R/585/2022 i datës 01.09.2022 i Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datën 12.08.2022, ka aplikuar në konkursin për lëvizje brenda kategorisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, i publikuar sipas njoftimit të datës 20.07.2022, ndërsa i shpallur për aplikim me datën 04.08.2022-15.08.2022, për pozitën “Zyrtar i lartë i komisionit për vendosje” në Qendrën Operative Komunikuese dhe Koordinuese-Divizioni i Komunikacionit Rrugor/Komisioni për Vendosje. Të njëjtës sipas Vendimit me numër të referencës 07/1-OISAP-R/568/2022 të datës 22.08.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos plotësimit të kriterit të konkursit, gjegjësisht mos dorëzimit e dokumentit të lëshuar nga gjykata kompetente, me të cilin vërtetohet që nuk është nën hetime.E pakënaqur me vendimin lidhur me refuzimin e aplikacionit nga ana e Udhëheqëses

së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me datën 29.08.2022 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore, ndërsa kjo e fundit me datën 01.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër të referencës 07/1-01SAP-R/585/2022 me të cilin ka refuzuar aplikacionin e ankueses, me arsyetimin se nuk i plotëson kriteret e konkursit pasi që e njëjta nuk ka bashkangjitur vërtetimin nga gjykata që nuk është i/e dënuar ose nuk është nën hetime.

Ankuesja, me datën 02.09.2022 ka parashtruar ankesë përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net me numër të protokollit 5079/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe me pretendimin ankimor se pas marrjes së kësaj certificate me datën 19.08.2022 edhe pse e ka bashkangjitur prapë i është refuzuar aplikacioni.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.09.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 09.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:5079/2022 të datës 02.09.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 07/1-01SAP-R/585/2022 të datës 01.09.2022 nga Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës; Vendimin me numër 07/1-01SAP-R/568/2022 të datës 22.08.2022 nga Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.09.2022 nga Policia e Kosovës lidhur me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Kërkesën e datës 10.06.2022 nga Drejtoria e Personelit në DPP- Prishtinë lidhur me aprovimin për fillimin e procedurës së shpalljes së konkurrimit; Konkursin e datës 20.07.2022 me numër të referencës RN00009437; Listën e aplikantëve, listën e aplikantëve në pritje dhe atyre të aprovuar të gjeneruara tek SIMBNJ; Aplikacionin e ankueses të datës 12.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë të punës, dokumentin e identifikimit të ankueses, formularët e vlerësimit të ankueses për vitin 2020 dhe 2021 dhe vërtetimin se e njëjta nuk ka masë të shqiptuar disiplinore të datës 10.08.2022; Njoftimin me numër 07/1-01SAP-R/570/2022 të datës 22.08.2022 lidhur me listën e ngushtë; Ankesën e ankueses të datës 29.08.2022 e parashtruar tek NJBNJ; E-mailin zyrtar të datës 30.08.2022 nga ankuesja lidhur me dërgimin e certifikatës nga gjykata mbi evidencën penale; Certifikatën e datës 19.08.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë lidhur me evidencën penale të ankueses; E-mailin zyrtar të datës 09.09.2022 lidhur me dërgimin e provave shtese nga ankuesja në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht konkursit me numër RN00009437, të datës 20.07.2022 për pozitën "Zyrtar i lartë i komisionit për vendosje" në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, tek dokumentacioni lidhur me rastin e aplikimit si kusht për dorëzimin e dokumenteve kanë qenë edhe : *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, kopjet e dëshmisë së punësimit, kopjet e dëshmisë së trajnimeve, kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, dokument i cili dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende si dhe vërtetimin nga gjykata që nuk është i dënuar dhe nuk është nen hetime. Të ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji",* ndërsa kushtet formale janë kërkuar: *Diploma e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik, Ekonomik Administrata Publike, Shkenca Politike si dhe drejtime të tjera të ngjashme dhe Përvoja e punës-se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale ne fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesja dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik ka dorëzuar aplikacionin dhe dokumentacionin e bashkangjitur, ku e njëjta posedon Diplomën me Nr.7924 të lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet që ka përfunduar studimet themelore me datën 19.04.2016 dhe ka marrë titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, e njëjta posedon Diplomën e Shkollës së Mesme Ekonomike,, Hoxhe Kadri Prishtina" në Prishtinë të datës 25.08.1997; Certifikatën Nr.224/2021 lidhur me përfundimin e trajnimit për kontabilitet menaxherial e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës-MPB; Certifikatën Nr.180/2021 lidhur me përfundimin e trajnimit për shkathtësitë e komunikimit nga data 26.05.2021-26.5.2021 e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës-MPB; Certifikatën me numër Prot.Nr.97/2019 lidhur me kryerjen e trajnimit për zbatimin e pakos së re ligjore për administratën publike ne praktike dhe kontrollin e brendshëm financiar dhe menaxhimi i kontratave publike për periudhën nga data 26-27.11.2019 e lëshuar nga ADA Consulting në Prishtinë; Certifikatën me numër No.2003/7 të datës 21.01.2003 e lëshuar nga Unioni Borterot ORT lidhur me përfundimin e kursit për kompjuter sipas programit të ORT-së për Windows 98 basics, word 2000, Excel 2000 dhe Outlook 2000; Kartën e aftësive me numër No.XP-0000023 e lëshuar me datën 06.09.20004 nga European Computer Driving Licence lidhur me përfundimin e trajnimit për kompjuter; Vërtetimin e datës 24.10.2008 të lëshuar nga Cactus për ankuesen lidhur me përfundimin e trajnimeve për kompjuter; Rekomandimin e datës 10.08.2022 nga Shefi i Njesisë për Koordinim, Administrim dhe Mbështetje të Trajnimeve tek Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës lidhur me rekomandimin e ankueses për punësim; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Formularët e vlerësimit të punës për vitin 2019 dhe 2020 si dhe vërtetimin me numër të referencës 07/1-01SAP-P/6630 të datës 10.08.2022 e lëshuar nga Shefi i sektorit të administratës dhe personelit në Policinë e Kosovës lidhur me përvojën e punës ne pozitën si staf civil nga data 25.06.2003 në Policinë e Kosovës dhe se e njëjta nuk ka të inicuar procedurë disiplinore.

Sa i përket plotësimit të kriterëve lidhur me konkursin për pozitën e lartcekur, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i'u referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 ku përcaktohet se "*kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë përveç tjerash janë: të mos jetë i dënuar me vendim të formës*



së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje", andaj mbi këtë bazë konstaton se kandidatët për pranim si nëpunës civil faktin që nuk janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë, duhet ta dëshmojnë me certifikatë të lëshuar nga gjykata kompetente, e që në rastin konkret bazuar në dëshmitë e ofruara nga ana e Policisë së Kosovës lidhur me dosjen e kandidates, e njëjta me rastin e aplikimit për këtë pozitë nuk e ka pasur të bashkangjitur këtë certifikatë, mirëpo e ka dorëzuar tek me datën 30.08.2022 përmes e-mailit zyrtar tek pas mbylljes së konkursit, i cili ka qenë i hapur nga data 04.08.2022-15.08.2022, andaj ndërlidhur me këtë fakt, Kolegji konstaton se meqenëse kandidatja e lartcekur nuk e ka bashkangjitur këtë dokument me rastin e aplikimit e njëjta edhe nuk është përfshirë në listën e ngushtë, meqë është kriter bazë për pranim të zyrtarëve publikë, konkretisht në këtë rast ankuesja nuk ka dorëzuar dokumentet siç kërkohet edhe me nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në faktet e lart cekura konstatohet se Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, bazuar në kompetencat e përcaktuara dhe me nenin 34 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 dhe paragrafin 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve dhe sipas Vendimit me numër të referencës 07/1-01SAP-R/570/2022 të datës 22.08.2022 ka refuzuar aplikacionin e ankueses për shkak të mos plotësimit të kriterëve për pozitën e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër të referencës 07/1-01SAP-R/568/2022 të datës 22.08.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ka konstatuar se ky vendim është nxjerr në pajtim me kriteret e përcaktuara në konkurs që të njëjtat janë derivat i kërkesave të përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë të përcaktuar si në nenin 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë ky vendim është në pajtim me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 5 të Rregullores (QRK)Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.... 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve..."*.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër të referencës 07/1-01SAP-R/585/2022 të datës 01.09.2022 mbi refuzimin e aplikacionit (ankesës së ankueses) të datës 29.08.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses për pozitën, "Zyrtar i lartë i komisionit për vendosje" në Qendrën Operative Komunikuese dhe Koordinuese-Divizioni i Komunikacionit



Rrugor/Komisioni për Vendosje, i shpallur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës.

Ashtu siç u tha me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.760/2022, 14/10/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtarë e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.